



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Autoriteti Kosovar i Konkurrencës**  
**Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority**

Prishtinë, më 08 Gusht 2022  
Vendimi Nr. 29/ 22

Duke u bazuar në nenet 11,13,15,16,17,18,26,27,34,51,55 par.1.5 të Ligjit 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012, për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, në mbledhjen e datës 08.08.2022, mori këtë;

**V E N D I M**

- I. LEJOHET** Përqendrimi i ndërmarrjeve, Yildirim Kosovo Mining Investment LLC (blerësi) dhe NKL Limited (shitësi) për blerje të aksioneve të NewCo Ferronikeli Complex LLC (targeti).

Yildirim Kosovo Mining Investment LLC, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Republikës të Kosovës, me seli në Rr. Ali Pashë Tepelena, Ivy Residence No.12b, Prishtinë, Kosovë dhe numër të biznesit 811933002.

NKL Limited, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe e organizuar sipas ligjeve të Mbretërisë së Bashkuar, me seli në Scalpel, kati 18, 52, Lime Street, Londër, Angli, EC3M 7AF dhe numër të regjistrimit të biznesit, 11246593.

NewCo Ferronikeli Complex LLC, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, e regjistruar me numër të biznesit 810507444, me zyrë të regjistruar në adresën Drenas, Ferronikeli, Kosovë, si dhe të kontrollit të vetëm indirekt mbi filialin e Target, NewCo Ferronikeli Complex sh.p.k është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar me nr. të biznesit M01810010D, me zyrë të regjistruar në adresën Rruga Papa Gjon Pali II, Ndërtesa Nr.12, Kati 11-të, Zyra nr.1206, Njësia Bashkiake Nr.2, Tiranë, Shqipëri.

- II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim, obligohet të paguaj taksë administrative prej 100.00 €, me shkronja (njëqind euro), dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në vlerë prej 3,000.00 € (me shkronja tre mijë Euro).

### ARSYETIM

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës (tutje ref. "Autoriteti"), më datë; 24.06.2022, ka pranuar kërkesën me Nr.Prot. 176/22-01/H, lidhur me njoftimin për Përqendrimin e ndërmarrjeve përmes Znj.Vjosa Shkodra Rr,CMS Adonnin Ascoli Cavasola Scamoni shpk, rruga Rexhep Luci, hyraj 13, nr. 4 10000 Prishtinë, Kosovë, për ndërmarrjet Yildirim Kosovo Mining Investment LLC (blerësi) dhe NKL Limited (shitësi) për blerje të aksioneve të NewCo Ferronikeli Complex LLC (targeti).

#### **Procedurat e ndjekura:**

1. Vlerësimi i Lëndës/dokumentacionit
2. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 08.07.2022.
3. Njoftimi për realizimin e përqendrimit ne ueb faqen e AKK-së më datë 12.07.2022
4. Më datë 31.05.2022, palët kanë nënshkruar Marrëveshjen për Shit-Blerje të Aksioneve me të cilin, blerësi do të fitojë pjesëmarrjen e plotë në kapitalin e shoqërisë si dhe të gjitha të drejtat përkatëse, dhe asetet e zotëruara nga shitësi, i cili zotëron direkt ose indirekt 100% të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë target dhe filialet e tij.

#### **Baza juridike;**

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, nga dokumentacioni i prezantuar në dosjen e lëndës, palët përmbushin detyrimin për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që;

- a) Qarkullimi i kombinuar i palëve në Kosovë, e kalon shumë 3 milion euro
- b) Kompania NKL Limited, ushtron kontroll të drejtpërdrejt mbi targetin (NewCo Ferronikeli Complex LLC) si dhe kontroll indirekt mbi filialin në Shqipëri.
- c) Kontrata e Shitblerjes ndërmjet palëve, më datë 31.05.2022
- d) Kërkesa për përqendrim është bërë për arsye se targeti gjendet në Kosovë.

## **Vlerësimi i Konkurrencës**

**Tregu Relevant;** Struktura e NewCo Ferronikel në Republikën e Kosovës nuk ndryshon.

**Tregu i produktit** - ka të bëjë me nxjerrjen, prodhimin, dhe tregtimin e produkteve minerale jo-metalike, nxjerrja e torfës, prodhimin e gazeve industriale, prodhimin e hekurit dhe çelikut bazik dhe prodhimin e aliazheve të hekurit.

**Tregu gjeografik** - Tregu gjeografik përkufizohet territori i Republikës së Kosovës.

## **Tregjet e Prekura**

Transaksioni nuk krijon tregje të prekura, pasi që Yildirim Grup nuk është aktive në Kosovë në mënyrë të drejtpërdrejt, tregu përkatës është vetëm tregu kosovar, ku targeti është aktiv, përkatësisht tregu kosovar për ofrimin e ferronikelit, i cili nuk do të shkaktojë ndonjë rritje të pjesës së tregut të Targetit duke ruajtur pozicionin aktual të Targetit në tregun përkatës kosovar dhe në të njëjtin nivel.

## **Efektet e konkurrencës në tregun përkatës, nga transaksioni i realizuar**

Transaksioni i propozuar do të realizohet në tregun gjeografik të Republikës së Kosovës, kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se, njëra nga palët (Targeti) është prezent në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit nuk mund të ketë efekt negativ në Kosovë, e rrjedhimisht nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në treg.

## **Shënim;**

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti - konkurruese do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

IV. Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva

## KOMISIONI

Neime Binaku-Isufi  
Kryetare

Kaltrina Sela  
Zv. Kryetare



Nafije Osdatuaj  
Anëtare

